



Prishtinë, 10.07.2025
Kodi i ZRRE-së: V_2796_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRrE/DMK_V_2706_05_25** i datës 22.05.2025;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës 17.06.2025.

në seancën e mbajtur më datë 10.07.2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZHET** Kundërshtimi i KESCO-s, ndaj Vendimit të DMK-së për konsumatorin R. H., me shifër DPR -90067214, si i pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2706_05_25 i datës 22.05.2025.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 22.05.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2706_05_25 me të cilin e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e konsumatorit R. H., lidhur me kontestimin e faturave të muajve 01-02/2025 dhe e ka obliguar KESCO-n që konsumatorin ta korrigjoj në vlerë financiare prej -9.10 € për periudhën kohore 12/2024 – 01/2025.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, Furnizuesi KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- KESCO-ja konstaton se shpenzimi i regjistruar në njehsorin me nr. 63609828 është i saktë. Faturimi për periudhën 12/2024 dhe 01/2025 bazohet në leximet AMR, të cilat gjendje ruhen dhe se kjo gjendje është vërtetuar edhe nga OSSH.
- DMK vendimin e saj e ka bazuar në leximin me përshkrimin CCP për periudhën 12/2024 dhe gabimisht ka konstatuar që leximi nuk është bërë dhe për këtë periudhë ka pasur faturim të vlerësuar dhe e obligon KESCO-n të bëjë shpërndarjen e kWh të regjistruar për periudhën 12/2024 – 01/2025.
- KESCO ka kërkuar informatat nga OSSH (KEDS) dhe ka pranuar gjendjet reale në periudhat kontestuese dhe gjithashtu sqaron se, përshkrimi në listat e leximit CCP nuk nënkupton me



patjetër faturim të vlerësuar, por në këtë rast dëshmohej edhe me të dhënat të sakta gjendja në ditën e leximit.

- Departamenti për konsumatorë në KESCO, kërkon nga Bordi i ZRrE-së, pezullimin e Vendimit të DMK-së me nr. ZRrE/DMK_V_2706_05_25 i dt. 22.05.2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2025 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Kundërshtimin e KESCO-s të datës 17.06.2025; Vendimin e DMK-së të datës 22.05.2025; Vendimin e KESCO-s të datës 20.02.2024; Kërkesat e konsumatorit në KESCO; Ankesën e konsumatorit në DMK të ZRrE-së të datës 25.02.2025; Transaksionet e konsumatorit, Rrjedhën e energjisë dhe Listat e Leximit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Kundërshtimi i KESCO-s **është i pabazuar**, sepse:

Në vështrim kronologjik të këtij rasti, Bordi ka gjetur se, me datë 21.01.2025, Departamenti i Faturimit në KESCO i ka dërguar konsumatorit faturën mujore me nr. 01250DPR-90067214, në vlerë prej 179.77 €, me gjendje të shpenzimeve prej **TL = 1255.98 kWh** dhe **TU = 561.11 kWh**, apo në total prej **1817.09 kWh** dhe me datë 19.02.2025, KESCO i ka dërguar konsumatorit faturën mujore me nr. 01250DPR-90067214, në vlerë prej 122.20 €, me gjendje të shpenzimeve prej **TL = 897.3 kWh** dhe **TU = 461.28 kWh**, apo në total prej **1358.58 kWh**. I pakënaqur me këto fatura, konsumatori ka parashtruar ankesë në KESCO, duke i kontestuar të njëjtat, nën dyshimet për faturim jo të saktë të energjisë elektrike me njehsorin elektrik me nr. 63609828.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të ankesës së konsumatorit, Departamenti për Kujdes ndaj Konsumatorëve në KESCO, lëshon një Vendim, me të cilin refuzohet ankesa e konsumatorit dhe atë duke u bazuar në Lista të leximit, Rrjedhë të Energjisë Elektrike dhe Transaksione, me arsyetimin se, njehsori është lexuar me rregull dhe nuk është evidentuar asnjë parregullsi në këtë pikë matëse.

Me datë 25.02.2025, i pakënaqur me këtë Përgjigje, konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, duke i kontestuar faturat e periudhës 01/2025 dhe 02/2025. Konsumatori i propozon DMK-së që ankesa të aprovohet, ashtu që fatura e kontestuar të rishqyrtohen.

Bazuar në analizën e përgjithshme që i është bërë Transaksioneve, Rrjedhës së Energjisë Elektrike dhe Listave të Leximit, vihet re që, konsumatori për muajin 12/2024 është faturuar me vlerësim/CCP/pa matje, por që, në lista të leximit nuk është evidentuar arsyeja e një faturimi të tillë. Ndërkaq, për periudhat e tjera, konsumatori është lexuar dhe është faturuar përmes AMR. Nga analizimi i mëtejshëm i Listave të Leximit, Bordi gjen se, konsumatorit i është ndërruar njehsori në muajin 01/2024, ashtu që, nga matja është larguar njehsori elektrik me nr. 62196487 dhe për matje është vendosur një njehsor i ri me nr. 63609828. Kështu, deri në këtë periudhë kohore, pra të ndërrimit të njehsorit, punëtorët e autorizuar të KEDS për periudha të caktuara kanë evidentuar që nuk kanë qasje në pikën matëse të



konsumatori si njehsori brenda ose – “metter inside” dhe që mungon pllomba ose - “missing seals”, “sugjerim për zhvendosje”, etj.

Për shkak që konsumatori nuk është lexuar me AMR për muajin 12/2024, por është faturuar me vlerësim/CCP në vlerë prej 45.25 €, dhe se nuk është evidentuar arsyeja e kësaj forme të leximit, DMK me të drejtë e ka bërë shpërndarjen e kWh për periudhën 12/2024 deri me 01/2025, dhe korrigjimi financiar i cili duhet aplikuar ndaj konsumatorit rezulton të jetë në vlerë prej -9.10 €. Kësisoj, Bordi konstaton se ky korrigjim si i tillë është i saktë dhe nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të KESCO-s.

DMK po ashtu e ka analizuar edhe faturën e kontestuar të muajit 02/2025, në vlerë prej 122.20 EUR dhe ka gjetur se, konsumatori për këtë periudhë kohore është lexuar përmes AMR dhe nuk është evidentuar asnjë parregullsi në këtë matëse. Rrjedhimisht, kjo faturë si e tillë është e saktë dhe reflekton shpenzimet reale të konsumatorit. DMK e ka bërë edhe shpërndarjen e kWh edhe për faturën e muajit 02/2025 dhe ka gjetur se konsumatorit nuk i takon korrigjim tjetër financiar.

Bordi po ashtu thekson se, duke u bazuar në nenin 28 – Faturimi, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji e ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar edhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit, Furnizuesi KESCO ka vepruar në harmoni me rregullativën ligjore në fuqi.*

Tutje, duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, *“të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRrE-ja”,* andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se i licencuari KESCO në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova konkrete.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Rregullën për Shkycjen, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s;
- Konsumatorit **R. H.**
- Arkivit të ZRrE-së.